



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

# INTEGRITET DHE GJITHËPËRFSHIRJE

*(Vetëvlerësimi nga stafi)*



2025

*Të nderuar kolegë,*

*Fuqia e institucionit tonë buron nga integriteti, profesionalizmi dhe përkushtimi i të gjithë neve që i japim jetë misionit. Çdo ide, çdo veprim dhe çdo përpjekje e përbashkët ndërton themelin e Zyrës Kombëtare të Auditimit, dukë e bërë atë më shumë se një vend pune, por hapësirë ku lidhen vlerat, pasioni dhe përkushtimi.*

*Vlerësimet e punonjësve sollën pasqyrë inkurajuese, se jemi organizatë me mision dhe vizion të qartë, standarde të larta profesionale dhe etike, me mjedis punë të bazuar në bashkëpunim, komunikim të hapur dhe respekt reciprok. Mbresëlënëse është veçanërisht ndjenja juaj e krenarisë që jeni pjesë e këtij institucioni, shenjë kjo e qartë e fuqisë së çdo kontributi.*

*Reflektimet dhe sugjerimet tuaja udhëheqin hapat tanë të ardhshëm, duke na ndihmuar të zgjerojmë motivimin, transparencën, mundësitë për zhvillim profesional si dhe bashkëpunimin. Ju jeni pasuria më e madhe e institucionit tonë, forca që e shtyn atë të zhvillohet dhe të përparojë çdo ditë.*

# Përmbledhje e Përgjithshme

Zyra Kombëtare e Auditimit ka realizuar një pyetësor të brendshëm me qëllim të mbledhjes së vlerësimeve të stafit lidhur me funksionimin e institucionit, kulturën organizative, mjedisin e punës dhe orientimin strategjik për periudhën e ardhshme. Pyetësori është plotësuar nga 118 punonjës, apo 69% e stafit, çka tregon përfshirje dhe përgjegjësi të lartë institucionale.

Rezultatet paraqesin një pasqyrë pozitive të të anketuarëve për ZKA-në, si në aspektin profesional ashtu edhe etik. Të anketuarit vlerësojnë qartësinë e misionit dhe vizionit, profesionalizmin, integritetin dhe mjedisin e punës. Komunikimi i brendshëm dhe bashkëpunimi ekipor konsiderohen në përgjithësi të mira, ndërsa raporti staf-menaxhment karakterizohet nga besimi dhe respekti reciprok. Shumica e të anketuarve kanë shprehur vlerësim për faktin që janë pjesë e këtij institucioni dhe e rekomandojnë ZKA-në si një vend të mirë pune.

Nga ana tjetër, janë identifikuar disa fusha që kërkojnë përmirësim të mëtejshëm. Motivimi i stafit mbetet si një nga sfidat kryesore, i ndërlidhur me kompensimin, vlerësimin e performancës dhe mekanizmat e stimulimit profesional. Po ashtu, është evidentuar nevoja për rritje të transparencës në proceset e avancimit në karrierë, forcim të komunikimit ndërdepartamental, modernizim të infrastrukturës teknologjike, si dhe menaxhim më të balancuar të ngarkesës së punës.



**171**  
punonjës



**118**  
përgjigje  
të plotësuar nga stafi



**69%**  
pjesëmarrje



**94.1%**  
rekomandime  
*vend i mirë për të punuar*

**95.8%** e të anketuarëve vlerësojnë se ZKA promovon në masë të madhe parimet e integritetit, objektivitetit dhe profesionalizmit



**89%** e të anketuarëve vlerësojnë pozitivisht mundësitë që ZKA ofron për trajnime dhe ngritje të kapaciteteve



**83.9%** e të anketuarëve pohojnë se ndihen të trajtuar në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim



# Misioni, vizioni dhe vlerat organizative

**100%**

e të anketuarve kanë deklaruar se, puna e tyre kontribuon drejtpërdrejtë në realizimin e misionit të ZKA-së



**93.2%**

e të anketuarve kanë deklaruar se vlerat organizative të ZKA-së janë të dukshme në kulturën e punës së përditshme






**97.5%**

e të anketuarve kanë deklaruar se misioni dhe vizioni i ZKA-së është mjaftueshëm i qartë



# Udhëheqja dhe komunikimi



# Mjedisi i punës dhe bashkëpunimi



**89%**

e të anketuarve raportojnë bashkëpunim të kënaqshëm ndërmjet kolegëve



**11%**

mendojnë se ka ende hapësirë për përmirësim



**87.3%**

e të anketuarve ndihen të respektuar dhe të trajtuar me drejtësi në vendin e punës



**12.7%**

kanë pikëpamje tjetër



**73.7%**




e të anketuarve ndihen të motivuar për të dhënë më të mirën në punën e tyre



**26.3%**

nuk e ndajnë këtë mendim

# Zhvillimi profesional dhe vlerësimi i performancës



# Etika, integriteti dhe transparenca

**95.8%** e të anketuarve vlerësojnë se ZKA, në masë të madhe promovon parimet e integritetit, objektivitetit dhe profesionalizmin



**83.9%** e të anketuarëve mendojnë se janë trajtuar në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim



**16.1%** nuk ndihen të trajtuar në mënyrë të barabartë

**81.4%** e të anketuarve mendojnë se ekziston nivel i mjaftueshëm i besimit ndërmjet stafit dhe menaxhmenti



**18.6%** ka një perceptim më pak pozitiv

# Motivimi dhe përkushtimi

Shumica e të anketuarëve ndihen krenarë dhe të privilegjuar që janë pjesë e ZKA-së, duke vlerësuar reputacionin, kredibilitetin dhe rolin e institucionit në forcimin e transparencës, llogaridhënies dhe integritetit



**94.1%** e të anketuarve do ta rekomandonin ZKA-në si vend të mirë për të punuar, çka tregon një nivel shumë të lartë besimit të stafit ndaj institucionit



ZKA perceptohet si vend pune që nxit profesionalizmin, bashkëpunimin dhe përgjegjësinë ndaj interesit publik.

Disa të anketuar shprehin rezerva, të ndërlidhura kryesisht me nivelin e pagave, largimin e stafit me përvojë, mungesën e motivimit dhe ndryshimet në klimën organizative.



# Propozimet nga të anketuarit për objektivat strategjike

**Cilësia dhe ndikimi i auditimit** - përmes avancimit të metodologjisë dhe raporteve, rritjes së numrit të auditimeve të performances dhe pajtueshmërisë, si dhe përdorimin e analizës së të dhënave dhe teknologjisë për auditime më efektive.

**Zhvillimi dhe motivimi i stafit** - përmes trajnimeve të avancuara, zhvillimit profesional të vazhdueshëm, krijimit të një sistemi transparent për promovim dhe shpërblim mbi bazën e performancës, si dhe ruajtjes dhe stimulimit të stafit me përvojë.

**Transformimi digjital dhe përmirësimi i menaxhimit të brendshëm** - duke integruar teknologjitë e reja për auditim dhe menaxhim procesesh, standardizuar dhe azhurnuar procedurat e brendshme, rritur transparencën dhe komunikimin me publikun dhe institucionet e audituara.

# Propozimet nga të anketuarit për fushat që kërkojnë përmirësim

**Motivimi dhe zhvillimi profesional i stafit** – përmes rregullimit të pagave dhe politikave të shpërblimit, zhvillimi i kapaciteteve profesionale përmes trajnimeve dhe çertifikimeve, shkëmbimin e përvojave me institucionet tjera audituese, si dhe mbajtja dhe përkrahja e stafit të kualifikuar.


**Komunikimi dhe koordinimi** – përmirësimi i rrjedhjes së informacionit, komunikim më efektiv dhe interaktiv brenda organizatës, forcim i bashkëpunimit ndërkolegial, vlerësimi i kontributit individual dhe promovimi i punës tonë me palët e interesit.

**Teknologjia dhe digjitalizimi** – avancimi i sistemeve dhe pajisjeve të TI për auditim si dhe mjete të tjera digjitale për mbledhje dhe analizë të dhënash.

**Metodologjia dhe menaxhimi i procesit të auditimit** - standardizimi dhe azhurnimi i metodologjive të auditimit, konsistenca në qasje audituese, shpërndarja e balancuar e detyrave, përmirësimi i planifikimit dhe balancim i garkesës së punës.

**Përmirësim i mjedisit të punës dhe mirëqenies** – sigurimi i një objekti më të përshtatshëm, krijimi i ambientit të rehatshëm dhe pa zhurmë, fleksibilitet në orar dhe punë nga shtëpia, si dhe aktivitete rekreative.





Zyra Kombëtare e Auditimit  
Lagjja Arbëria  
Rr. Ahmet Krasniqi, 210  
10000 Prishtina  
Republika e Kosovës